

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Gazetarja zbulon detaje nga hetimet për Hysenin: Ndërkombëtarët kërkuar veprim nga SPAK - Euronews Albania
ADRESA	https://euronews.al/gazetarja-zbulon-detaje-nga-hetimet-per-hysenin-nderkombetaret-kerkuar-veprim-nga-spak/
BURIMI	euronews.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	23 shtator 2026, 19:32:05 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	23 shtator 2026, 19:31:34 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	827b7ef6edc96efd9cd60ed90499a021c344fff2abeb39d7668a9f5ac4071954
TEKSTI	905c6150f961e3b763248e2fba5fade7c4933ef90de54e6926bb8776baa51
PAMJA	7821ce9a7b55da46348fc488d72ebcc373739df50d5f02e4664112947308a039

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	1e02cc3b9f360a1a3928f1fcb265654af67c84cfbc8679fee3bbe4ee510448d3
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	0a84bfe3f4510e3e6e98dba2fbf96359a912d940176f0d9eba05fd7152dcd223
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahase hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/1e02cc3b9f360a1a3928f1fcb265654af67c84cfbc8679fee3bbe4ee510448d3>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.


Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

TREND

Asambleja e OKB Vlora Hyseni Sali Berisha Donald Trump SHBA

AKTUALITET | LAJM KRYESOR

Gazetarja zbulon detaje nga hetimet për Hysenin: Ndërkombëtarët kërkuar veprim nga SPAK



23 Shtator 2026 | 21:31

Gazetarja Anduena Llabani, e ftuar në "Now me Eri Mëhillin", ndau detaje të tjera në lidhje me hetimet e SPAK-ut në dosjen ku është përfshirë edhe drejtuesha e SHISH-it, Vlora Hyseni. Llabani tha se, sipas informacioneve të saj, ndërkombëtarët kanë kërkuar që SPAK-u të veprojë për këtë çështje.

Sipas gazetares, fakti që Ergys Agasi ka pasur komunikim me drejtuesen e SHISH-it ka ngritur pikëpyetje te ndërkombëtarët. Llabani tha se hetimet nuk duhen parë vetëm në raport me marrëdhënien Agasi-Hyseni, duke përmendur edhe materiale të sekuestruara nga SPAK-u, përfshirë regjistrime video, telefona, mesazhe dhe informacione që, sipas saj, lidhen me shërbimin informativ.

Llabani tha gjithashtu se në një automjet të përdorur nga Agasi janë gjetur materiale dhe informacione të shërbimit, ndërsa shtoi se nuk dihet ende konkretisht se çfarë përmbajnë ato materiale apo nëse janë origjinale.

"Ka dy vjet që ndërkombëtarët kërkojnë që SPAK-u të veprojë. Pse u veprua tani? Besoj se ka ardhur nga presioni ndërkombëtar. Akses i Agasit në shërbimin informativ i ka bërë ndërkombëtarët të ngrenë pikëpyetje të mëdha. S'mund të ndalem vetëm te historia Agasi-Hyseni. Mos harrojmë se në zyrën e Agasit kemi regjistrime video, të cilat Agasi në të shumtën e rasteve i përdorte për shantazh. Dikush që e njeh thonte që ishte bërë paranojak, por materialet sigurisht janë marrë nga SPAK-u, janë zbardhur një pjesë e tyre, një pjesë tjetër ende. Kemi parë majën e ajsbergut, që janë telefonat dhe SMS-të dhe çfarë shishe vere dhe kaq. Nëse një person në kërkim, siç ishte Agasi, komunikon në mënyrë permanente dhe lëviz me mjete të shërbimit informativ me shefen e shërbimit informativ, do të thotë se këtu ka diçka që nuk shkon. Ndërkohë, ajo në punën e saj njihej si korrekte dhe e egër në punë, ku u kërkonte llogari për çdo gjë punonjësve të saj. Është e vërtetë se në makinën e Agasit kanë qenë materiale të shërbimit. Në këtë makinë të tij ka pasur materiale dhe informacione të shërbimit. Nuk e di çfarë janë konkretisht, nga çfarë përbëhen, a janë origjinale apo janë marrë nga zyra e shefes. S'ka pasur nevojë ky t'i merrte, se shikonte a do ta takonte Vlora Hyseni apo jo. E ka takuar ose në zyrën e tij, ose në resort. Një ish-ministër i Brendshëm më tha se e kishte nxjerrë nga zyra Vlora Hyseni, pasi pas takimeve që kishte me krerët e institucioneve i është kërkuar informacion më shumë se sa duhet. Ndërkohë, ministri e dinte se ku shkonte ajo pas takimit. Më tha: 'Isha më i zgjuar, i kisha vënë dy veta mbrapa që e shikonin ku po shkonte ajo', tha gazetarja.

LAJMI I FUNDIT

21:21 Sulme të reja me viktima në Ukrainë, goditet qendra ku ndodhet selia e partisë së Zelensky-t gjatë fjalimit në OKB

21:14 Bordi i Paqes në OKB: Rindërtimi i Gazës do të kërkojë 71.4 miliardë dollarë gjatë dekadës së ardhshme

21:05 Arrestohet në Itali 47-vjeçari i dënuar me 15 vite burg në Shqipëri

SHPËRNDAJE
ARTIKULLIN

20:57 Çfarë po planifikon PD? Gazetari: Berisha kërkon aksion më të ashpër në Parlament dhe jashtë tij

20:48 Vijon protesta në Tiranë në ditën e 116-të, nesër tubim para Kuvendit

20:28 Kapet në Rusi 'bosi' shqiptar i 'kartelit' të drogës Shpëtim Aliu

TESTIM

Shiko në:

LAJME TË SUGJERUARA

AKTUALITET | VENDI

Arrestohet në Itali 47-vjeçari i dënuar me 15 vite burg në Shqipëri

Autoritetet italiane kanë arrestuar Alok Mittra, 47 vjeç, i shpallur në kërkim nga drejtësia shqiptare. Ai pritet të ekstradohet drejt Shqipërisë, pasi në vitin 2024...

21:05 | 23/09/2026

AKTUALITET | VENDI

Vijon protesta në Tiranë në ditën e 116-të, nesër tubim para Kuvendit

Protesta qytetare në Tiranë këtë të mërkurë hyri në ditën e saj të 116-të. Ashtu sikurse e kanë nisur që prej orës 19:30, si fillim...

20:48 | 23/09/2026

AKTUALITET | AUDIO NEWS | EURONEWS ALBANIA | LAJM KRYESOR | VENDI

Kapet në Rusi ‘bosi’ shqiptar i ‘kartelit’ te drogës Shpëtim Aliu

Është arrestuar në Rusi, me qëllim ekstradimi, Shpëtim Aliu, i njohur edhe me emrin Salvatore, i shpallur në kërkim nga SPAK si drejtues i një...

20:28 | 23/09/2026

TEMA

Vendi
Rajoni
Bota
Video

SHËRBIME

Live
Lajmi fundit
Na ndiqni
Euronews Radio
Për persona me aftësi të kufizuara

KOMPANIA

Rreth Euronews
Kushtet e përdorimit
Politika e cookie
Kontakti

Follow Euronews on all platforms:

Copyright © Euronews 2026

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.